




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2004-2008



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2004-2008



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)
Data e botimit: Dhjetor 2009
© : Enti i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së
në internet: www.ks-gov.net/esk

Parathënie

Publikimi Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2004 – 2008 është vazhdimësi e aktivitetit të Entit Statistikor të Kosovës (ESK). Ky botim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

Ky publikim është përgatitur nga: Ilir T. Berisha – Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Xhevdie Fetahu, Shqiponjë Bektashi në bashkëpunim me, Clementina Ivan – Ungureanu eksperte kyçe në Llogari Kombëtare (“Mbështetja e mëtutjeshme ESK-se”, projekt i Unionit Evropian).

ESK-ja i është mirënjohës Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) si dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për ofrimin e të dhënave në lidhje me këtë publikim.

Komentet, propozimet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura dhe ato mund të drejtohen në këtë e-mail: economic@ks-gov.net, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të këtij publikimi.

Prishtinë, Dhjetor 2009

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së
z. Avni Kastrati

Lista e Shkurtesave

BQK	Banka Qendrore e Kosovës
ESA	Llogaritë e Sistemit Evropian (European System of Accounts)
ESK	Enti i Statistikor i Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
:	Mungojnë të dhënat
–	Nuk aplikohet

Përmbajtja

1	Hyrje	4
2	Të hyrat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare për Qeverinë e Përgjithshme	5
2.1.	Të hyrat - Qeveria e Përgjithshme	5
	Tabela 1: Struktura e Të Hyrave të Qeverisë së Përgjithshme.....	6
2.2.	Shpenzimet – Qeveria e Përgjithshme.....	7
3	Të hyrat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare për Qeverinë Qendrore.....	8
3.1.	Të hyrat – Qeveria Qendrore	8
3.2.	Shpenzimet – Qeveria Qendrore	9
	Tabela 2: Agjensionet shpenzuese të Kosovës.....	10
4	Të hyrat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare për Qeverinë Lokale dhe Qendrore	11
4.1.	Të hyrat – Qeveria Lokale.....	11
4.2.	Shpenzimet – Qeveria Lokale	12
5	Sistemi i fondit pensional	13
	Tabela 3: Treguesit kryesor për shtyllën e 2-të pensionale të Kosovës.....	13
	Shtojca Statistike: Llogaritë e hollësishme për Qeverinë e Përgjithshme	14
	Tabela 1: Të ardhurat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare e Qeverisë së Përgjithshme.	15
	Tabela 2: Të ardhurat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare e Qeverisë Qendrore	16
	Tabela 3: Të ardhurat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare e Qeverisë Lokale.....	17

1 Hyrje

Publikimi paraqet një pasqyrë të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën 2004 – 2008, bazuar në mbledhjen e të dhënave administrative dhe kalkulimeve të ESK. Si rregull i përgjithshëm ka për qëllim pajtueshmërinë maksimale të shifrave të publikuara me standardet e ESA 95 dhe manualin e FMN për statistikat e Financave Qeveritare.


Burimet e të dhënave janë: Ministria e Ekonomisë dhe Financave – Departamenti i Thesarit, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Njësia e Koordinimit të Donatorëve në zyrën e Kryeministrit.

2 Të hyrat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare për Qeverinë e Përgjithshme

2.1. Të hyrat - Qeveria e Përgjithshme

Totali i të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme në vitin 2008 ishte 1.303,3 milion Euro, që do të thotë se kemi një rritje të të hyrave në krahasim me vitin e kaluar. Ndhimat e donatorëve ishin 343,2 milion Euro (306,3 dhuruesit e ndihmave nga bota e jashtme dhe 36,8 milion Euro si grante të investimeve), të cilat paraqesin 26,3% te totalit të të hyrave. Pjesëmarrja e ndihmave të donatorëve në të hyrat e Qeverisë Qendrore në vitin 2008 ishte me e vogël në krahasim me vitet paraprake (në vitin 2008 ishte 26,3, në vitin 2007 ishte 27,3%, ne vitin 2006 ishte 35,2% ne vitin 2005 ishte 37,5 dhe në vitin 2004 ishte 44,9%). Struktura e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 1:

Grafiku 1: Të hyrat - Qeveria e Përgjithshme 2008



Burimi: Thesari, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Qendra e koordinimit te donatorëve ne zyrën e kryeministrit te Kosovës.

Pjesa më e madhe e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme është rezultat i aktivitetit të importit të njësive ekonomike në Kosovë, që e përbëjnë tatimet e mbledhura në kufi. Struktura e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme është e prezantuar në Tabelën 1, prej të cilave:

- Të Hyrat Kufitare paraqesin: tatimin në vlerën e shtuar në kufi, akciza e jashtme në kufi, akciza e brendshme, detyrime doganore të importit, taksa të ndryshme doganore si dhe taksa doganore të paspecifikuara,

- Te Hyrat e brendshme paraqesin: tatimin në vlerën e shtuar – vendore, tatimi në të ardhura personale, tatimi në korporata, tatimi në fitim, tatimi i paragjykuar dhe të hyrat tjera nga administrata tatimore të paspecifikuara.

- Donacionet paraqesin fondet e Qeverisë të marra nga donatorët.

- Të Hyrat nga interesi dhe shitja përfshijnë pranimet në nivelin Qendror dhe Lokal, të cilat nuk mbledhen nga Administrata tatimore, por që administrohen nga organizatat tjera buxhetore Qendrore dhe Lokale.

Tabela 1: Struktura e Të Hyrave të Qeverisë së Përgjithshme

Vitet	Të hyrat kufitare	Të hyrat e brendshme	Donacionet	Te hyrat nga interesi dhe shitja	Totali
2004	42.8%	9.5%	44.9%	2.9%	100%
2005	45.9%	13.5%	37.5%	3.1%	100%
2006	42.7%	16.8%	35.2%	5.2%	100%
2007	42.8%	22.6%	27.3%	7.2%	100%
2008	47.4%	18.9%	26.3%	7.4%	100%


Burimi : Thesari, Qendra e koordinimit të donatorëve në Zyrën e Kryeministrit

2.2. Shpenzimet – Qeveria e Përgjithshme

Në vitin 2008 totali i shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme ishte 1.300,9 milion Euro prej të cilave shpenzimet rrjedhëse përfaqësuan 69,6%. Konsumi i ndërmjetëm (p.sh blerja e mallrave dhe shërbimeve), paraqet kategorinë më të rëndësishme të shpenzimeve rrjedhëse. Ttransferet rrjedhëse të ekonomive shtëpiake pësuan një ngritje ne vitin 2008 krahasuar me vitin 2007.

Në vitin 2008, Qeveria e Përgjithshme regjistroi 2,3 milion Euro si fuqi financiare. Struktura e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 2:

Grafiku 2: Shpenzimet - Qeveria e Përgjithshme 2008




3 Të hyrat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare për Qeverinë Qendrore

3.1. Të hyrat – Qeveria Qendrore

Vlera e përgjithshme e të hyrave të Qeverisë Qendrore në vitin 2008 ishte 1.270,8 milion Euro, e cila përfaqëson 97,2% te totalit të të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme. Struktura e të hyrave është e prezantuar në Grafikon 3.

Te hyrat totale te Qeverise Qendrore ne vitin 2008 janë me te ulta ne krahasim me vitin e kaluar me afërsisht 100 milion euro. Kjo është për shkak të faktit se në vitin 2007, IPKO u bë operatori i dytë i telefonisë mobile dhe për këtë aktivitet ka paguar 75 milion Euro.


Grafiku 3: Të hyrat - Qeveria Qendrore 2008



3.2. Shpenzimet – Qeveria Qendrore

Shpenzimet e Qeverisë Qendrore në vitin 2008 ishin 1.256,2 milion Euro, të cilat paraqesin 84,3% të totalit të shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme. Pjesa kryesore e shpenzimeve ishte për konsumin e ndërmjetëm (25,3% nga totali i shpenzimeve të Qeverisë Qendrore), transferet rrjedhëse të Qeverisë Lokale (12,7%), bruto akumulimi i kapitalit fiks (25,4%) dhe për pagesat e kompensimit të punëtorëve (18,4%). Struktura e shpenzimeve është e prezantuar në Grafikon 4:

Grafiku 4: Shpenzimet - Qeveria Qendrore 2008



Nga totali i shumës së shpenzimeve, vlera prej 752,7 milion Euro është shpenzuar nga Ministrinë dhe agjensionet publike. Vlera e shpenzimeve për periudhën 2004 - 2008 për secilën Ministri dhe agjension publik janë të prezantuara në tabelën Nr. 2:

Tabela 2: Agjensinet shpenzuese të Kosovës

(në milion Euro)

Agjensioni	2004	2005	2006	2007	2008
Kuvendi i Kosovës	7.4	7.6	5.6	6.0	7.7
Zyra e Kryetarit	3.2	3.7	1.4	1.1	1.2
Zyra e Kryeministrit	2.2	3.3	3.8	3.3	4.1
Ministria e Ekonomisë dhe Financave	23.1	13.6	11.1	10.6	83.3
Ministria e Shërbimeve Publike	21.8	11.5	7.7	7.5	17.5
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2.7	4.8	5.9	6.5	9.8
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1.7	2.2	2.9	2.8	4.2
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	43.4	27.1	26.5	22.6	127.6
Ministria e Shëndetësisë	66.6	52.7	50.7	49.4	62.6
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	7.9	6.2	6.6	6.8	10.8
Ministria e Arsimit, Shkëncës dhe Teknologjisë	27.6	30.7	27.5	35.4	62.9
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	108.1	123.9	127.2	121.6	146.4
Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor	3.8	11.2	10.0	5.8	4.7
Ministria për Kthim të Komuniteteve	0.0	11.6	9.2	6.1	6.3
Ministria e Pushtetit Lokal	0.0	0.8	2.0	1.4	5.4
Ministria e Energjisë dhe Minierave	0.0	1.8	2.3	1.5	3.7
Ministria e Punëve të Brendshme	0.0	0.0	3.2	5.6	11.1
Ministria e Drejtësisë	0.0	0.0	0.5	14.4	15.3
Ministria e Punëve të Jashtme					1.2
Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës					0.4
Komisioni i Pavarur i Prokurimit	0.0	0.4	0.3	0.3	0.3
Akademia e Shkencave dhe Arteve	0.0	0.3	0.4	0.4	0.4
Fondi i Rindërtimit	0.0	0.0	1.8	1.6	1.3
Autoriteti Rregullativ i Telekomunikimit	0.0	0.0	0.5	0.6	1.4
Agjensioni Antikorupsion	0.0	0.0	0.0	0.3	0.3
Agjensioni i Prokurimit Publik				0.1	0.1
Dogana	7.0	7.0	8.3	7.7	8.8
Zyra e Auditorit Gjeneral	1.1	1.0	2.2	0.9	0.9
Drejtorati i Çështjeve Administrative	5.0	3.6	6.2	2.1	0.1
Zyra e Kordinatorit të TMK	17.8	15.2	18.3	17.7	18.1
Shërbimi Policor i Kosovës	49.4	54.9	50.9	52.8	59.1
Qendra Financiare e Informacionit	0.0	0.0	0.2	0.3	0.4
Departmenti i Drejtësisë	13.9	14.6	14.1	1.1	1.2
Shërbimet e Burgjeve	10.5	9.6	10.0	0.0	0.0
Drejtorati i Çështjeve Rurale	1.6	0.3	0.0	0.0	0.0
Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës	1.6	1.8	2.1	2.1	2.2
Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit	94.6	78.2	57.2	78.2	49.4
Zyra Rregullative e Ujit dhe Mbeturinave	4.1	1.3	0.1	0.2	0.2
Zyra Rregullative e Energjisë	0.0	0.0	0.2	0.4	0.4
Agjensioni Kosovar i Privatizimit					3.8
Organi Shqyrtues I Prokurimit					0.1
Zyra e Menaxhimit të Frekuencave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Zyra e Aviacionit Civil	0.0	0.0	0.6	0.9	0.9
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	0.0	1.9	1.7	1.8	0.8
Komisioni i Pavarur i Mediave	0.4	0.4	0.4	0.3	0.5
Komisioni Qëndror për Zgjedhje	3.0	0.5	0.4	4.8	1.1
Ombudspersoni	0.4	0.4	0.5	0.4	0.4
Radio Televizioni i Kosovës	1.0	0.6	0.0	0.0	0.0
Instituti Gjyqësor i Kosovës	0.2	0.2	0.3	0.3	0.3
Zyra për Çështje të Komuniteteve	13.0	4.7	5.8	0.0	0.0
Zyra për Çështje Gjinore	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	0.0	0.0	0.1	9.0	10.0
Agjensioni Kosovar i Pronës				1.6	3.8
Totali	544.4	509.6	487.1	494.1	752.7

Burimi: Thesari, Ministria e Ekonomisë dhe Financave
 Vërejtje: Nuk janë të përfshira grantet e përcaktuara të donatorëve


4 Të hyrat, shpenzimet dhe neto aftësia financiare për Qeverinë Lokale dhe Qendrore

4.1. Të hyrat – Qeveria Lokale

Të hyrat e Qeverisë Lokale në vitin 2008 ishin rreth 30,9 milion Euro (duke përjashtuar transferet rrjedhëse prej Qeverisë Qendrore), të cilat pasqyrojnë 2,4% të të hyrave totale të Qeverisë së Përgjithshme. Pjesën kryesore të të hyrave e përbejnë tatimet rrjedhëse në të ardhura dhe pasuri (71,4% nga totali i të hyrave të Qeverisë Lokale) dhe të hyrave tjera nga interesi dhe shitja (15,5%). Të hyrat e pranuar nga Qeveria Lokale në vitin 2008 ishin më të mëdha në krahasim me vitet paraprake. Qeveria Lokale pranoi në vitin 2008 vlerën prej 160,1 milion Euro nga Qeveria Qendrore si transfero rrjedhëse për edukim, shëndetësi, shërbimet e përgjithshme, rendi dhe siguria publike, etj.

Grafiku 5 pasqyron strukturën e të hyrave të Qeverisë Lokale duke përjashtuar transferet rrjedhëse nga Qeveria Qendrore.


Grafiku 5: Të hyrat - Qeveria Lokale 2008



4.2. Shpenzimet – Qeveria Lokale

Shpenzimet e Qeverisë Lokale në vitin 2008 ishin 204,8 milion Euro, të cilat përfaqësojnë 15,7% të totalit të shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme. Pjesa kryesore e shpenzimeve ishte për kompensimet e punëtorëve (55,8% nga totali i shpenzimeve të Qeverisë Lokale) dhe për pagesat e mallrave dhe shërbimeve - konsum të ndërmjetëm (14,7%). Struktura e shpenzimeve është e prezantuar në Grafikon 6:

Grafiku 6: Shpenzimet - Qeveria Lokale 2008



5 Sistemi i fondit pensional

Sistemi i sigurimit social është disi më i komplikuar. Sistemi pensional është i përbërë nga 3 shtylla, secila prej tyre dallon në mënyrën se si financohen dhe në shtresën e popullatës të cilën e mbulojnë:

Shtylla e parë - është skema e asistencës themelore sociale, e cila është e zbatueshme jo vetëm për të moshuarit. Kjo është e integruar në Qeverinë Qendrore, që do të thotë se është pjesë përbërëse e Qeverisë. Pagesat pensionale nën këtë konsiderohen si dobi sociale të përfshira në shpenzimet të Transferet rrjedhëse të Ekonomive Shtëpiake. Kjo është e financuar nga faturat e Qeverisë së Përgjithshme.

Shtylla e dytë - është skema e kursimeve të detyrueshme pensionale. Kjo skemë ka filluar së funksionari në gusht të vitit 2002, kur punëdhënësit e mëdhenj dhe agjencitë shtetërore kanë qene të obliguar për kontribute. Prej vitit 2003 skema e kursimeve të obligueshme është zgjeruar për të përfshirë të gjithë punonjësit e Kosovës e të vetpunësuarit. Kursimet e detyrueshme pensionale administrohen dhe menaxhohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). TKPK pranon kontribute pensionale në vlerë prej 10% të pagës bruto të ndara në mes të punëdhënësve dhe punëtorëve (5%+5%), ndërsa për të vetpunësuarit 10 % të të ardhurave të fituara. TKPK i investon këto mjete përmes menaxhuesve të specializuar të mjeteve.

Shtylla III - Nenet e Rregullores mbi Pensionet mbi skemat vullnetare sigurojnë që këto skema të jenë të sigurta, të financuara në mënyrë adekuate dhe transparente. Skemat e pensioneve vullnetare paraqesin opsion për biznese e institucione të ndryshme financiare dhe mund të financohen nga kontributet e punëdhënësve dhe/ose të të punësuarve. Departamenti i Pensioneve në [BQK](#) liçencon dhe monitoron skemat vullnetare.

Vlen të theksohet që sistemi kryesor pensional, i cili tani është në formë embrionale, do të jetë shumë më i rëndësishëm në vitet që vijnë. Kjo pjesë është regjistruar jashtë Qeverisë. Kontributet e pagesave të pensioneve janë rrjedha në mes të Ekonomive shtëpiake dhe sektorit të korporatave financiare.

Nga këndvështrimi ekonomik nuk duket të jetë plotësisht e kënaqshme që sistemi kryesor pensional i detyrueshëm nuk është reflektuar në llogarinë e Qeverisë. Kështu që publikimet e ESK-së për Llogaritë Qeveritare, në parim përmbajnë një pasqyrë, pro memoria, të situatës së shtyllës së financuar (kontributet, të hyrat e aseteve, pagesat dhe asetet).

Tabela 3: Treguesit kryesor për shtyllën e 2-të pensionale të Kosovës

(në milion Euro)

Vitet	Kontributet e mbledhura te pensioneve	Kthimet e investimeve	Provizionet, kthimet dhe pagesat tjera	Sallo e aseteve pensionale
2004	44	1	1	83
2005	52	11	2	144
2006	57	16	28	188
2007	64	6	5	252
2008	73	-91*	6	228

Burimi: Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës

*Në vitin 2008 për shkak të krizës globale financiare çmimi i aksionit ra në 0.8601 euro (nga 1.2184 euro sa ishte ai në dhjetor 2007), duke shënuar kështu rënie prej 29.4% në vlerë.

**Shtojca Statistikore: Llogaritë e hollësishme për Qeverinë e
Përgjithshme**

Tabela 1: Të ardhurat, shpenzimet dhe neto aftësia financuese e Qeverisë së Përgjithshme

	(në milion Euro)				
	2004	2005	2006	2007	2008
Të Hyrat	1088.8	1000.8	1093.2	1234.3	1303.3
<i>Te hyrat rrjedhëse</i>	1003.0	963.5	1049.3	1214.6	1266.4
Tatimet rrjedhëse në të ardhura dhe pasuri	83.9	101.5	133.3	159.7	201.4
<i>paguar nga ekonomitë shtëpiake</i>	27.8	45.1	40.6	48.0	65.4
<i>paguar nga ndërmarrjet</i>	56.1	56.5	92.6	111.8	136.1
Tatimet në prodhime dhe importe	473.3	480.9	515.9	664.1	660.0
<i>tatimet në produkte</i>	468.7	474.7	501.2	577.1	641.9
<i>tatimet tjera të prodhimt</i>	4.6	6.2	14.6	87.0	18.1
Transferet rrjedhëse	411.9	347.1	351.9	327.7	328.0
<i>grantet e donatorëve nga bota e jashtme</i>	403.9	339.3	342.9	317.3	306.3
<i>tjerrat</i>	8.0	7.8	9.0	10.4	21.7
Të hyrat nga interesi	3.6	2.7	9.4	11.5	10.6
Shitjet	30.3	31.3	38.9	43.6	46.6
<i>Të ardhurat kapitale</i>	85.8	37.3	43.9	27.6	213.7
<i>tatimet kapitale</i>	1.1	1.3	1.6	7.9	19.7
<i>grantet e investimeve</i>	84.7	36.0	42.3	19.7	36.8
Shpenzimet	1203.8	1044.6	1043.4	1003.3	1300.9
<i>Shpenzimet rrjedhëse</i>	927.7	861.5	850.6	814.2	905.1
<i>kompensimi i punëtorëve</i>	316.8	323.8	303.2	327.6	345.1
<i>konsumi i ndermjetëm</i>	423.9	343.5	380.5	331.1	347.4
<i>transferet rrjedhëse të ekonomive shtëpiake</i>	89.0	69.4	121.3	116.4	137.9
<i>subvencionet</i>	97.9	124.9	45.6	39.0	74.7
<i>Shpenzimet kapitale</i>	276.1	183.2	192.8	189.0	395.8
<i>bruto akumulimi i kapitalit fiks</i>	242.3	137.2	167.0	139.6	376.5
<i>transfere kapitale</i>	33.8	45.9	25.8	49.4	19.4
Fuqia financiare neto	-115.0	-43.9	49.8	231.0	2.3

Tabela 2: Të ardhurat, shpenzimet dhe neto aftësia financuese e Qeverisë Qendrore

	(në milion Euro)				
	2004	2005	2006	2007	2008
Te hyrat	1066.0	976.1	1075.5	1213.5	1270.8
<i>Te hyrat rrjedhese</i>	981.3	940.2	1033.3	1187.8	1217.3
Tatimet rrjedhëse në të ardhura dhe pasuri	76.2	92.6	121.6	145.6	179.3
<i>paguar nga ekonomitë shtëpiake</i>	20.2	36.2	29.1	34.0	43.5
<i>paguar nga ndërmarrjet</i>	56.0	56.4	92.5	111.6	135.8
Tatimet në prodhime dhe importe	470.7	477.6	512.4	661.7	656.0
<i>tatimet në produkte</i>	468.7	474.6	499.5	575.0	638.4
<i>tatimet tjera të prodhimit</i>	2.0	3.0	12.9	86.7	17.6
Transferet tjera rrjedhese	411.8	346.9	351.9	327.7	328.0
<i>grantet e donatorëve nga bota e jashtme¹</i>	403.9	339.3	342.9	317.3	306.3
<i>tjerat</i>	7.8	7.6	9.0	10.4	21.7
Të hyrat nga interesi	3.5	2.7	9.4	11.5	10.6
Shitjet	19.1	20.3	38.0	41.2	43.3
<i>Të ardhurat kapitale</i>	84.7	36.0	42.3	25.8	53.6
tatimet kapitale	0.0	0.0	0	6.1	18.2
grantet e investimeve	84.7	36.0	42.3	19.7	35.3
Shpenzimet	1144.3	1008.3	1017.6	976.8	1256.2
Shpenzimet rrjedhëse ²	798.0	735.9	718.9	683.7	757.3
<i>kompensimi i punëtorëve</i>	232.0	221.6	201.6	225.3	230.8
<i>konsumi i ndërmjetëm</i>	379.0	321.4	353.0	305.7	317.3
<i>transferet rrjedhëse të ekonomive shtëpiake</i>	89.0	69.4	120.4	115.4	136.7
<i>subvencionet</i>	97.9	123.5	43.9	37.3	72.5
Shpenzimet kapitale	219.7	144.4	156.6	152.5	338.8
<i>bruto akumulimi i kapitalit fiks</i>	185.9	98.5	130.7	103.1	319.4
<i>transfere kapitale</i>	33.8	45.9	25.8	49.4	19.4
Transferet rrjedhese te Qeverisë Lokale	126.6	128.0	142.1	140.6	160.1
Fuqia financiare neto	-78.2	-32.1	58.0	236.8	14.6

¹ Grantet e donatorëve nga bota e jashtme përfshijnë DDG, PIP dhe stafin e UNMIK-ut

² Shpenzimet rrjedhëse përfshijnë shpenzimet nga DDG, PIP dhe stafi i UNMIK-ut të dedikuara për kompensimet e punëtorëve dhe konsumin e ndërmjetëm, me qëllim që të jemi konsistent me publikimin e BPV.

Tabela 3: Të ardhurat, shpenzimet dhe neto aftësia financuese e Qeverisë Lokale

	(në milion Euro)				
	2004	2005	2006	2007	2008
Të hyrat	149.4	151.4	159.7	161.3	191.0
<i>Të hyrat rrjedhëse</i>	148.3	150.1	158.1	159.5	189.5
Tatimet rrjedhëse në të ardhura dhe pasuri	7.7	9.0	11.6	14.1	22.1
<i>paguar nga ekonomitë shtëpiake</i>	7.6	8.9	11.5	14.0	21.9
<i>paguar nga ndërmarrjet</i>	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2
Tatimet në prodhime dhe importe	2.6	3.3	3.5	2.3	4.0
<i>tatimet në produkte</i>	0.0	0.1	1.7	2.1	3.5
<i>tatimet tjera të prodhimit</i>	2.6	3.2	1.8	0.2	0.5
Transferet rrjedhëse	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0
<i>grantet e donatorëve nga bota e jashtme</i>	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<i>tjerat</i>	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0
Të hyrat nga interesi	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shitjet	11.2	11.0	0.9	2.4	3.3
Transferet rrjedhëse prej Qeverisë Qendrore	126.6	126.8	142.1	140.6	160.1
<i>Të ardhurat kapitale</i>	1.1	1.3	1.6	1.8	1.5
tatimet kapitale	1.1	1.3	1.6	1.8	1.5
grantet e investimeve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzimet	186.1	164.4	167.9	167.1	204.8
Shpenzimet rrjedhëse	129.7	125.6	131.7	130.5	147.8
<i>kompensimi i punëtorëve</i>	84.9	102.2	101.6	102.3	114.2
<i>konsumi i ndërmjetëm</i>	44.8	22.0	27.4	25.5	30.2
<i>transferet rrjedhëse të ekonomive shtëpiake</i>	0.0	0.0	0.9	1.0	1.2
<i>subvencionet</i>	0.0	1.4	1.7	1.8	2.2
Shpenzimet kapitale	56.4	38.8	36.3	36.6	57.1
<i>bruto akumulimi i kapitalit fiks</i>	56.4	38.8	36.3	36.6	57.1
<i>transfere kapitale</i>	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Transferet rrjedhëse të Qeverisë Lokale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Fuqia financiare neto	-36.8	-12.9	-8.2	-5.8	-13.8

Vërejtje: Në të hyrat e Qeverisë Lokale janë të përfshira edhe 160,1 milion Euro si transfere rrjedhëse të Qeverisë Qendrore .

Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës së Kosovës, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Enti i Statistikës së Kosovës vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi më 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

Struktura organizative e ESK-së, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës.

Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.

Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruet terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

Misioni i Entit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**
- **Telefonat: Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111
Drejtori: +381 (0) 38 235 545**
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail: ekonomik@ks-gov.net**
- **Ueb-faqe: www.ks-gov.net/esk**